



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.741/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Afijete Sada Glligjani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkritazi me apelin e Subjektit Politik Pokret za Gora- PG, dega në Dragash, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.741/2021 i datës 03.11.2021, i paraqitur nga Subjekti Politik Pokret za Gora- PG, dega në Dragash për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për Subjektin Politik Pokret za Gora- PG, dega në Dragash në vendvotimin 0516A/01R, në fshatin Radeshë Komuna e Dragashit.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 03.11.2021 nga Subjekti Politik Pokret za Gora- PG, në të cilën pretendon se anëtarit e Komisionit Zgjedhor përkatësisht z.Izeta Izeti, me numër personal 1006559626 me numër rendor të ID 195, në vendvotimin 0516A/01R në komunën e Dragashit, fshati Radeshë ky subjekt kishte 35 vota pas numërimit të rregullt të votave nga anëtarët e komisionit zgjedhor në atë vendvotim. Megjithatë, në të njëjtën vendvotim Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur vetëm 11 vota web faqen e saj për këtë subjekt politik. Në bazë të formularit të bashkangjitur për harmonizimin e të dhënave dhe rezultateve nga vendvotimi 0516A/01R, dhe pretendimeve të anëtarit të përmendur të komisionit zgjedhor, 11 vota janë në fakt numri i votave të kandidatëve tanë në listë, ndërsa numri i votave që subjekti politik Pokret za Gora-PG fitoi në atë vendvotim në atë klasë është 35. Andaj parashtruesi i apelit pretendon se ankesa e tyre bazohet në argumente ku në bazë të formularit të bashkangjitur shihet se rezultatet janë ndryshuar nga individë në atë qendër

votimi dhe se për subjektin politik të tyre fillimisht është shënuar numri i saktë i votave dhe më pas është përmirësuar (ndryshuar) shifra prej 35 votash dhe janë shkruar vetëm 11 vota. Në të njëjtin formular vërehet se janë bërë korrigjime të shumta të paligjshme, që si rezultat jep se numri i votave të fituara nuk përputhet me numrin total të zgjedhësve që kanë dalë për të votuar me numrin e fletëve të pavlefshme. Apeluesi ndër të tjera thekson se pretendon se në vendvotimin e përmendur ka ndodhur një vjedhje e rëndë e votave andaj ka kërkuar nga PZAP që në vendvotimin 0516A/01R në komunën e Dragashit, fshati Radeshë, të bëhet verifikimi i materialit zgjedhor dhe bëhet rinumërimi i votave. Apelit i ka bashkangjitur një kopje të rezultateve të publikuara në web faqen e KQZ-së, një kopje të formularit për harmonizimin e të dhënave dhe rezultateve dhe një kope të kartës së identifikimit të anëtarit të Komisionit Zgjedhor të tyre.

PZAP, me datë 04.11.2021, i ka dërguar kërkesë për përgjigje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me të cilën ka kërkuar që të përgjigjet deri me datë 04.11.2021, ora 15:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.11.2021, të KQZ-së theksohet se në bazë të Rregullës Zgjedhore 06/2013, procedura e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve nuk lejon asnjë formular të rezultateve të kalojë (të procedohet si i rregullt) nëse nuk përputhen votat e subjekteve me votat e kandidatëve që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota atëherë Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në auditim ose subjekti ka vota dhe kandidatë nuk kanë vota formulari procedohet si i rregullt dhe shkon në auditim. Ndër të tjera është theksuar se auditimi kontrollon të gjitha këto raste dhe në bazë të gjeturave përgatit raportin dhe QNR në bazë të raportit të auditimit i rekomandohet KQZ-së që vendvotimet që kanë probleme të kësaj natyre të rinumërohen. Andaj asnjë formular që nuk ka përputhje nuk mund të procedohet si i rregullt dhe i njëjti i nënshtrohet auditimit kështu që vendvotimi në fjalë është verifikuar dhe i njëjti nuk është rekomanduar nga QNR-ja.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës për të vërtetuar gjendjen faktike të rastit konkret, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, ashtu që edhe pse pasi verifikoi listën e vendvotimeve të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) konstatoi se në vendvotimin me nr.0516A/01R, në Komunën e Dragashit, Subjekti Politik Pokret za Gora ka gjithsej 11 vota e jo 35 ashtu siç pretendon në apelin e parashtruar mirëpo nga provat e bashkangjitura krahas apelit përkatësisht Formularit të Rezultateve të Kandidatëve vërehet se ka ndërhyrje tek numri total i votave tek Subjekti Politik Pokret za Gora- PG ashtu që duket qartë se mbi numrin 35 është bërë ndërhyrje dhe është shkruar numri 11.

Andaj ky panel, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 741/2021 më datën 05.11.2021.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.